



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr 112/02-13587  
Dt: 27.08.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës, me datë 27.08.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

- Formohet komisioni për mbikëqyrjen e kontratës për shfrytëzimin e pronës komunale – Parkingun, me numër – 01-353/01-12845, në këtë përbërje:
  - Albana Bakalli - Kryesuese e komisionit
  - Selami Tuzi – anëtar
  - Shqipërim Hyseni – anëtar
- Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të ndërmer veprime konform legjislacionit në fuqi:
  - Të mbikëqyr realizimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës - parkingun.
  - Të përgatitë raporte të rregullta gjashtë (6) mujore të monitorimit, realizimit të kontratës dhe ta dorëzojë në zyrën e Kryetarit.
  - Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, komisioni obligohet që në çdo kohë të njoftoj kryetarin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat tjera të përcaktuara në kontratë.
  - Të bëj faturimin për çdo muaj dhe të njoftoj shfrytëzuesin për pagesë sipas kontratës.
  - Komisioni duhet të bëj dorëzimin - pranimi e pronës komunale – parkingut, më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini  
  
Kryetar i Komunës së Gjakovës